



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:000545
Datë: 18.03.2024
Numri i dokumentit: 05465332

Ac.nr.7881/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Bujar Muzaqi anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.K. nga P., Rrxxxx me numër personal të identifikimit xxxx, të cilin me autorizim e përfaqësojnë “K. A.” me avokatët e saj nga Pr., kundër të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – Spitali Rajonal në Prizren, me objekt kontesti kompensimi i pagave jubilarë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.27/22, të datës 12.09.2022 në seancën e kolegjit të mbajtur më 12.03.2024 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT e bazuar ankesa e të paditurës, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës-Spitali Rajonal në Prizren, ashtu që: NDRYSHOHET PJESËRISHT aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.27/22, i datës 12.09.2022 në pikën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit lidhur me kompensimin në emër të shpërblimit jubilar, ashtu që lidhur me këtë pjesë të kërkesëpadisë gjykohet si vijon: APROVOHET PJESËRISHT e bazuar kërkesëpadia e paditësit A. K. nga Prizreni dhe DETYROHET e paditura, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – Spitali Rajonal në Prizren që paditësit A. K. nga Prizreni, në emër të kompensimit të dy pagave jubilarë, t’ia kompensoj shumën e përgjithshme prej 850.68 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë (datë: 05.01.2022) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm, ndërsa përtej shumës së aprovuar refuzohet kërkesëpadia e paditësit.

II. Pika III e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.27/22, i datës 12.09.2022 mbetet i pashqyrtuar.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.27/22 të datës 12.09.2022, në pikën e parë të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit A.K. nga P.. Në pikën e dytë e ka detyruar të paditurën, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – Spitali Rajonal në Prizren që paditësit A. K. nga P., në emër të kompensimit të pagave jubilarë, t’ia kompensoj shumën e përgjithshme prej 1,330.64 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë (datë: 05.01.2022) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm. Në pikën e tretë të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë prej 125 euro, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta prishë aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthejë në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka ushtruar përgjkegjeje në ankesë duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet ankimore të të paditurës me propozimin që Gjykata e Apelit ta refuzojë ankesën si të pa bazuar ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, par.1, pika d) dhe e), si dhe nenit 200 dhe 201, pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është pjesërisht e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, A. K. nga P., përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, me datë 05.01.2022, ka parashtruar padi kundër të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – Spitali Rajonal në Prizren për kompensimin e dy pagave jubilarë.

Gjykata e shkallës së parë fillimisht përmes Aktvendimit C.nr.27/22 të datës 14.07.2022 ia kthenë në plotësim padinë paditësit, ndërsa ky i fundit përmes parashtrësës së datës 22.7.2022 precizon kërkesëpadinë e tij dhe atë tani kërkon shumën prej 850.00 Euro në emër të dy pagave jubilarë.

Gjykata po ashtu, pas shqyrtimit paraprak të padisë përmes aktvendimit numër 27/22 të datës 08.08.2022 e ka detyruar të paditurën që në afat prej 15 ditësh nga dorëzimi i padisë bashkë me shkresa të lëndës, ti paraqesë gjykatës përgjigje në padi në formë të shkruar me paralajmërim se në qoftë se brenda afatit ligjor të këtij aktvendimi nuk e paraqet përgjegjjen në padi, gjykata do të merr aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë –mosbindjes po qe se plotësohen kushtet e parapara me dispozitat e nenin 150 paragrafi 1 pika a, b, c e LPK-së.

Aktvendimi është pranuar nga e paditura me datë 15.08.2022, sipas fletë dërgesës për dorëzim personal, mirëpo e paditura nuk ka ushtruar përgjegje në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, ka nxjerrë aktgjykimin për shkak të pa dëgjueshmërisë-mosbindjes C.nr.27/22 të datës 12.09.2022, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë theksoi se themelësia e kërkesëpadisë del nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, nga vërtetimi me numër të protokollit kontrata 636 e datës 07.05.2021 e lëshuar nga e paditura ku vërtetohet se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në Spitalin e Përgjithshëm “Prim.Dr.Daut Mustafa në Prizren nga data 01.09.2022, ndërsa sipas listës së pagës me numër EM00037685 të lëshuar nga buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se paditësi realizon pagë mujore në shumën prej 425 euro. Në fund, gjykata e aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke e mbështetur vendimin e saj në nenin 17 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2, të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë. Për sa i përket llogaritjes së kamatës ligjore, gjykata vendosi sipas nenit 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet procedurale vendimin e mori bazuar në nenin 449 dhe nenin 452 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimin i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, par. 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, mirëpo gabimisht është zbatuar e drejta materiale për pjesën e ndryshuar, për çka edhe kjo pjesë e dispozitivit të Aktgjykimit të atakuar, është dashur të ndryshohen, për sa i përket kërkesës për kompensim lartësisë së shpërblimit jubilar.

Gjykata e shkallës së parë i ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e shpërblimit jubilar. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë lidhur me bazën e përgjegjësisë së të paditurës për kompensimin e shpërblimeve jubilarë (bazën juridike të kërkesëpadisë), i pranon në tërësi Gjykata e Apelit, pasi që me të drejtë vërtetimi i kësaj baze bazohet në provat materiale përkatëse. Si rrjedhojë e këtyre, Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket vërtetimit të bazës juridike të kërkesëpadisë së paditësit.

Në anën tjetër, Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të bazuara pretendimet ankimore të të paditurës për aplikimin e gabuar të drejtës materiale për shumën e gjykuar për paditësin në raport me lartësinë e shpërblimit jubilar, prandaj në këtë drejtim gjykata e shkallës së dytë e aprovoi pjesërisht ankesën e të paditurës, e ndryshoj aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykoi si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, duke vlerësuar se shuma e aprovuara nga gjykata e shkallës së parë për dy paga jubilarë është e lartë dhe nuk është e bazuar në pagën mujore që ka marr paditësi që është shuma prej 425.34 Euro ($425.34 \times 2 = 850.68$ Euro).

Gjykata e Apelit nuk e pranon qëndrimin dhe përfundimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, sa i përket lartësisë së komensimit, të cilin në këtë rast ia ka gjykuar paditësit si në pikën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, dhe vlerëson se pavarësisht gjendjes së vërtetuar faktike dhe mospërfshirjes së aktgjykimit të atakuar me shkelje esenciale të procedurës në këtë pjesë të aktgjykimit, gjykata sa i përket lartësisë së kompensimit për paditësin, ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, kur paditësit ia ka caktuar shumë prej 1,330.64 Euro në emër të shpërblimit jubilar, e cila shumë nuk është në harmoni me pagën e paditësit.

Me nenin 4 paragrafi 3 të Kontratës Kolektive Sektoriale, e cila ka hyrë në fuqi nga data 11.06.2018, në të cilën dispozitë është përcaktuar se *“Përfitues të beneficioneve të cilat dalin nga kjo marrëveshje dhe të cilat bazohen në Ligjin e Punës janë të gjithë punëtorët shëndetësor, ndërsa beneficionet/dobitë që dalin nga marrëveshjet e që nuk janë pjesë e Ligjit të Punës i gëzojnë vetëm anëtarët FSSHK-së”*. Si dhe neni 17 pika 3, 4 dhe 5 të kësaj kontrate përcakton se *“Punëmarrësi ka të drejtë në kompensimin e pagës së 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit. Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: 3.1. Për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një page mujore të tij; 3.2. Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij; 3.3. Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. 4. Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf*

Por, Gjykata e Apelit gjatë vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se qëndrojnë pjesërisht pretendimet e të paditurës lidhur me lartësinë e shumë e cila duhet kompensuar në emër të 2 (dy) pagave jubilarë, me çka sipas vlerësimit të kësaj Gjykate kemi zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Gjatë shikimit të shkresave të lëndës vërehet se gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit duke e detyruar të paditurën që paditësen ta kompensojë me 2 (dy) paga mujore në emër të shpërblimit jubilar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të datës 11.06.2018, të lidhur dhe nënshkruar nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK-së) dhe Ministrisë së Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, e cila është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës dhe se kërkesëpadia e paditësit për sa i përket bazës ligjore të saj është në tërësi e bazuar, mirëpo gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të gabuar ka përllogaritur vlerën e shumë e cila duhet kompensuar. Kjo për faktin se bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale, me rastin e llogaritjes së lartësisë së shumë e cila shpërblimit jubilar, për bazë merren pagat e fundit të cilat i merr apo i ka marr i punësuar nga punëdhënësi. Duke u bazuar në listën e pagave me numër EM00037685 në emër të paditësit, Gjykata e Apelit vërtetoi faktin se paditësi pagën mujore e ka arkëtuar në vlerë prej 425.34 euro, e jo 665.32 euro siç është llogaritur në mënyrë të gabuar nga gjykata e shkallës së parë sepse paga prej 665.32 euro përfshinë edhe shtesën në shëndetësi prej 45.76 euro dhe kujdestaritë në shumë prej 254.61 euro e si rrjedhojë nuk është pagë bazë. Sipas përllogaritjes së thjeshtë matematikore për 20 vite përvojë pune, paditëses i takon kompensimi në lartësi prej

850 euro (2 x 425.34 euro), andaj gjykata e shkallës së dytë, vlerësoi se duhet të ndryshohet pjesërisht pika e I dhe II e diapozitivit të aktgjykimit ankimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase me rastin e kompensimit të shpërblimit jubilar paguhet vetëm paga neto por jo edhe shtesat si pjesë e kësaj page në shumën prej 300.52 euro në rastin konkret.

Gjithashtu, edhe vendosja lidhur me kamatëvonesën, është në përputhje të plotë me nenin 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton detyrimin e debitorit në pagesën e kamatëvonesës si pasojë e vonesës në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit, e në rastin konkret e paditura meqë, është vonuar dhe nuk ka përmbushë detyrimin e saj ndaj kreditorit në afatin e përcaktuar me kontratë kolektive, atëherë e njëjta i detyrohet në përmbushjen e detyrimit së bashku me kamatëvonesën në shkallë prej 8% vjetore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pika III e diapozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.27/22, i datës 12.09.2022 mbetet i pashqyrtuar bazuar në nenin 194 të LPK-ës, pasi që asnjë palë mdërgjyqëse këtë pjesë të aktgjykimit nuk e ka atakuar me ankesë.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga nenet 194, 195.1 pika e) lidhur me nenin 201, pika b) dhe d) të LPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.7881/2022, datë 12.03.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Ardian Ajvazi